Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 943126
Data 06.11.26

Prishtinë, 09 tetor 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3423_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në,

- Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26, Nenin 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenin 6 dhe 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Nenin 5,6 dhe 7 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.ZRRE/Nr.07/2017);
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, dorëzuar në Rregullator me datë 28.04.2026 nga Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit "KEK SH.A."-TC Kosova "A" , adresa: rruga "Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- VENDIMIN Nr.:26/2087/MMPH të datës 17.8.2026, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për suspendim të përkoshëm për periudhë dy (2) vjeçare të aplikimit të normave të emisioneve dhe cilësisë së mjedsit në rastin e aplikimit të KEK TC Kosova A, për pajisje me Leje Mjedisore të Integruar,

në seancën e mbajtur me datë 9 tetor 2026, nxori këtë:

V E N D I M

I. **I LËSHOHET LICENCA** për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës (NUI 811290808) – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC **"Kosova A"** me numër licence **ZRRE/Li_115/26,** sipas Vendimit Nr.: 26/2087/MMPH të datës 17.8.2026 të lëshuar nga Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për periudhën nga **9 tetor 2026** deri **17 gusht 2028,** me mundësi vazhdimi nëse i licencuari aplikon jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës.

II. **OBLIGOHE**T KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejen Mjedisore të Integruar nga Ministria përkatëse dhe kopjen e së njëjtës ta dërgojë në Rregullator, njëkohësisht të informoj Rregullatorin mbi masat e marra për sigurimin e kësaj leje nga Ministria përkatëse.

III. **OBLIGOHET** KEK SH.A të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për KEK SH.A TC "Kosova A" të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

IV. **OBLIGOHET** KEK SH.A të përmbush kushtet e licencës të specifikuara në licencën **ZRRE/Li_115/26.**

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.04.2026 ka pranuar Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit-TC "Kosova A".

- Sipas Nenit 32 paragrafi 3 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kohëzgjatja e licencës mund të zgjatet/vazhdohet nëse i licencuari parashtron kërkesë me shkrim për vazhdim licene, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës. Në këtë rast, aplikacioni i KEK SH.A nuk konsiderohet vazhdim licence, pasi që kërkesa për vazhdim licence nuk është bërë brenda këtij afati.

- KEK SH.A ka dorëzuar Aplikacioni me dokumentacionin përkatës për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga TC Kosova A, në pajtim me Nenin 8 dhe 9 të rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

- Në pamundësi që KEK SH.A të pajiset me Leje Mjedisore të Integruar nga MMPHI, Bordi i Rregullatorit, që nga viti 2011 për çdo vit i ka vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike ndërmarrjes KEK SH.A -TC "Kosova A" (vendimet për vazhdim licence: V_380_2011 i datës 30 shtator 2011; V_437_2012 i datës 01 tetor 2012; V_556_2013 i datës 06 shtator 2013; V_652_2014 i datës 03 tetor 2014; V_749_2015 i datës 16 korrik 2015; V_843_2016 i datës 03 tetor 2016 dhe V_1032_2018 i datës 24 shtator 2018, V_1185_2019 i datës 14 tetor 2019; V_1290_2020 i datës 30 shtator 2020; V_1416_2021 i datës 04 tetor 2021, V_1764_2023 i datës 21 shtator 2023 dhe Vendimi V_2438_2024, i datës 30 shtator 2024), duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të Vendimeve, ta sigurojë nga Ministria përkatëse Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në Rregullator.

- KEK SH.A me rastin e aplikimit për licencim të prodhimit të energjisë elektrike, nuk ka dorëzuar Lejen Mjedisore të Integruar siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, por ka dorëzuar VENDIMIN Nr.26/2087/MMPH dt.17.8.2026 për këtë çështje, në dispozitiv të së cilit përveç tjerash thuhet:
  - *Suspendohet përkohësisht për periudhë **dy (2) vjeçare** aplikimi i normave të emisioneve dhe cilësisë së mjedisit në rastin e aplikimit të Korporatës Energjetike të Kosovës.*
  - *MMPH ka pranuar dhe është duke e shqyrtuar kërkesën e KEK SH.A TC Kosova A për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar, sipas Ligjit Nr.03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.*
  - *Duke u nisur nga fakti se KEK-u është ndërmarrje me interes vital për Kosovën, MMPH do ta mbështes me një Njoftim të praktikuar deri më tani, për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për ta vazhduar licencën në ZRRE.*
  - *Pasi që zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartëcekur kërkojnë analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të KEK-ut (TC Kosova A), që paraqesin një kompleks të madh industrial, por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme do të kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me KEK-un për të planifikuar përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis.*
  - *Pas shqyrtimit të aplikacioni për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar (e cila është në procedurë) dhe pas plotësimit të kushteve sipas Nenit 6 dhe 9 të Ligjit Nr.03/L-043 për PKIN, MMPH do të lëshojë vendimin për leje mjedisore të integruar.*

- Në po të njëjtin Vendim është edhe sqarimi shtesë si në vijim: *me Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE/NERP) parashihet që TC Kosova A të vazhdoj punën me kusht që të përmbush standardet e parapara me Direktivën e Impianteve me Djegje të Mëdha (Directive 2001/80/EC) deri në vitin 2022 dhe të vazhdoj punën më tutje nëse i përmbush kushtet sipas direktivës për Emisionet Industriale (Directive 2010/75).*

- Vlen të theksohet se me 4 tetor 2026 KEK SH.A - TC Kosova A i kishte skaduar afati i licencës për operim, mirëpor ka vazhduar operimin deri me 9 tetor 2026 sipas Aktvendimit të Gjykatës Administrative të Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me numër AP.nr.712/2026 me të cilin APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit, Korporata Energjetike e Kosovës për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të padisë.

- Licenca e lëshuar me datë 04 tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li_05/06_A), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/12_A), e modifikuar me 06.09.2013 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/13_A), e modifikuar me 13.04.2017 (Nr. i licencës ZRRE/Li_05/17_A), tani e lëshuar me numër licence **ZRRE/Li_115/26** do të jetë e vlefshme sipas pikës I. të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6)** muaj para skadimit të afatit të licencës si dhe është në pajtim me plotësimin e kushteve të licencës nr.ZRRE/Li_115/16 të datës 9.10.2026, të lëshuar nga Rregullatori.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës dhe dëshmive të bashkangjitura sipas aplikacionit për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të dorëzuar nga KEK SHA.A, ka vlerësuar ato dhe ka ka konsideruar se janë plotësuar dëshmitë relavante për lëshimin e licencës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Driton Gojani, Kryesues

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Vendimi iu dërgohet:
- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) - TC Kosova A
- Arkivit të ZRRE-së